



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 23/prot.
83

Tiranë, më 14.06.2024

VENDIM

Nr. 1087, Datë 14 .06 .2024

**“PËR VENDIJE GJOBE NDAJ NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK
PËR REFUZIMIN E PRANIMIT TË INSPEKTIMEVE NË MBËSHTETJE TË
VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

| | | |
|------|----------------|------------|
| Z. | Denar BIBA | Kryetar |
| Znj. | Leida MATJA | Zv/Kryetar |
| Znj. | Rezana KONOMI | Anëtar |
| Z. | Durim KRAJA | Anëtar |
| Znj. | Fatjola DELIJA | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 14 .06.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për refuzimin e pranimit të inspektimeve në mbështetje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 73, pika 1, germa (c) dhe (ç) i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit

që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.

2. Gjatë procedurave hetimore është konstatuar se sjellja e ndërmarrjes Arlis SHPK në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.
3. Në mbështetje të nenit 35 të ligjit nr. 9121, datë 28.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, si edhe autorizimit të inspektimit nr. 23/55, datë 20.05.2024, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës në datën 23.05.2024 u paraqitën në adresën e ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK, Rruga “Muhedin Llagani”, Pallati Vala, kati 1, nr.7, Tiranë, për të realizuar inspektimin pranë kësaj ndërmarrje.
4. Gjatë inspektimit në ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, inspektorët e Sekretariatit autorizuar me shkrim nga Komisioni për kryerjen e inspektimeve, u refuzuan për dhënien e çdo lloj informacioni që lidhej me objektin dhe qëllimin e inspektimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 36, germa (b), (c), (ç) dhe (d) e ligjit nr. 9121/2003.
5. Në zbatim të nenit 35, pika 2 e ligjit nr. 9121/2003 punonjësve të ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK ju vu në dispozicion autorizimi nr. 23/55, datë 20.05.2024, i cili përmban objektin dhe qëllimin e inspektimit, si dhe u vunë në dijeni për sanksionet e parashikuara në nenin 73, pika 1 germa (c) dhe (ç) të këtij ligji.
6. Kur ndërmarrjet refuzojnë të pranojnë inspektimet në mbështetje të vendimit të marrë, ose refuzojnë t’u përgjigjen pyetjeve për faktet, ose pengojnë inspektimin, në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, nenin 26 dhe nenin 73, pika 1, germa (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Gjorbitjen e ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për shkelje të lehtë të konkurrencës, konkretisht të nenit 73, germa (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003 në masën 48,392 (dyzetë e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) Lekë

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

()

Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

()


Anëtar

Durim KRAJA

()

Anëtar

Fatjola DELIJA

()

Denar BIBA

()

Kryetar

